



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 2 Prill 2021

Nr: 14

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 08, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 01.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Elvin LAKO	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë përfaqësuar nga z. Eridian Saliçanji

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 08, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë me objekt 1. Ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. 2. Miratimin e fletës së votimit për 12 qarqet e RSH për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 sipas variantit ku në përmbajtje të fletës së votimit kandidatët të identifikohen me numra.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### **VËREN:**

Ankuesi Partia Socialiste e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr, 08 regj., datë 01.04.2021.

Në mbledhjen e datës 02.04.2021, ora 11:00, pas relatimit të z. Koli Bele dhe diskutimit të përfaqësuesit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 08 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 08, datë 01.04.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 03.04.2021, në orën 11:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Koli BELE** - **Relator**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Elvin LAKO** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

